



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 26.12.2018, e cila filloi në orën 14:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Migjen Shala (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Sokol Berisha (AAK) dhe Yll Bogaj (AAK). Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Fiknete Bejta (AAK), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA) dhe Bukurie Canolli (LB).

**Munguan:** Visare Gashi (PSD), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Valbona Petrovci, e pavarur, Drilon Pireva (PSD), Uran Ismaili (PDK) dhe Baton Dushi (Nisma).

**Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit i cili tha se jemi në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Prishtinës e thirrur me kërkesën e Kryetarit të Komunës z. Shpend Ahmeti, me një pikë të rendit të ditës:

- 1. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve Ndërmarrjes Publike Lokale "Pallati i Rinisë" SH.A në Prishtinë dhe Ndërmarrjes "IMN Kosova".**

---

Faqe 1 nga 6

## Kryesuesi hapi diskutimin

**Shpend Ahmeti**, Kryetar tha se tashmë siç e dini "Pallati i Rinisë" ka kaluar në pronësi të Komunës së Prishtinës, e kemi regjistruar përfundimisht edhe si ndërmarrje në Agjensionin e Regjistrimit dhe tashmë jemi 100% pronarë. Ky pallat siç e dini e ka një problem dhe kur e kemi marrë e kemi diskutuar që do ta bëjmë rimëkëmbjen e tij. Problemin e parë që ne kemi hasur ka qenë problemi me paga, dhe ky problem e ka një adresë e që ka të bëjë me faktin që kur është djegur "Pallati i Rinisë" magazina e cila ka qenë përfundimllë e madhe kanë qenë disa biznese private të vendosura aty, të cilave ju ka djegur krejt malli. Ato biznese e kanë paditur "Pallatin e Rinisë" dhe e kanë fituar rastin gjyqësor dhe tashmë është vendimi i formës së prerë, dhe është detyruar "Pallati i Rinisë" që me i paguar 2.3 milion euro ka qenë dëmi i cili është identifikuar nga djegia e mallit.

Po ashtu edhe KEDS-i e ka shkëputur rrymën sepse ka borxh mbi 100 mijë euro, i ka borxh edhe Termokosit, Administratës Tatimore të Kosovës, të gjitha këto të cilat e kanë arritur shumën të cilën sot e kanë propozuar që të ju vjen si shumë për "Pallatin e Rinisë". Pra, në këtë shumë 3.757.619 euro. Pas kësaj vjen hapi i radhës kur na duhet me i mbledhur borxhet e "Pallatit të Rinisë" e borxhet karshi "Pallatit të Rinisë" janë 600 mijë euro, dhe ne tashmë përmes aksionarëve dhe bordit do të kërkojmë me angazhimin e përmbaruesve që ta mbledhim këtë borxh.

Sa i përket Ndërmarrjes IMN "Kosova", e njohur Tullëtorja, është bërë Vendimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës që Tullëtorja të shpallet zonë e interesit publik për Komunën e Prishtinës, pra, mos të privatizohet. At tokë do ta shfrytëzojmë për projekte të ndryshme. Në vitin 2017 ka hy në fuqi ndryshimi i Ligjit për Ndërmarrjet Publike, që lejon që na me e marrë në pronësi Tullëtoren, s cila ka vlerë diku 25 milion euro, sepse ka shumë tokë, ka pronë, ndërsa ne me ligj obligohemi ta paguajmë vetëm 20%, që caktohet për punëtorët e ish Tullëtorës.

Ne kemi arritur ta negociojmë një marrëveshje me AKP-në që obligimet ndaj punëtorëve mos të paguajmë krejt për njëherë, por që ti paguajmë gjysmën e shumës sivjet, e gjysmën tjetër kah fundi i vitit 2019. Me këtë kjo pronë do të kalojë në pronësi të Komunës së Prishtinës, dhe mund ta përdorim për sport, arsim, kulturë, banim, të gjitha ato të cilat ne mendojmë se janë më të mira.

**Halim Halimi** tha se tash meqenëse na është kthyer Pallati i Rinisë", është bërë shumë punë e mirë, po faktikisht tash ne po duhet me i paguar borxhet, të cilat janë në një shumë të madhe diku afër 100 milion. Këto të cilat i tha kryetari këtu, këto është dashur ekzekutivi, është dashur dikush prej ekzekutivit me i qit në letër dhe secili prej nesh me i pas sepse është fjala për mbi 6 milion euro që po i paguan Komuna, dhe Komuna po i paguan prej mjeteve të cilat kanë qenë të destinuara për projekte kapitale.

Këto mjete merren prej shpronësimeve e në vend se me e rritur këtë fond, ne po e cungojmë, po e zvogëlojmë, sepse kemi nevojë për çerdhe, për shkolla, kemi nevojë për ambulanca etj. etj. Si grup parlamentar kemi një qëndrim që do ta përkrahim, sepse kjo iniciativë ka rrjedh edhe më herët, d.m.th. edhe në kohën e mëhershme është bërë një iniciativë me e kthyer "Pallatin e Rinisë" në pronë komunale.

Sa i përket Ndërmarrjes IMN "Kosova", ish Tjegullorja si GP e kemi analizuar se ai borxh prej 20% duhet të paguhet, të ju jepen punëtorëve. Gjithashtu edhe Tjegullorja e ka një sipërfaqe toke bukur të madhe, 7-8 ha, kështu që kjo është me rëndësi, dhe ne si GP do ta votojmë.

**Vala Peshku** tha se edhe ne do ta përkrahim këtë propozimvendim se është në të mirën e qytetarëve.

**Vjosa Hamiti-Krasniqi** tha se LVV-ja qysh në mandatin e parë qeverisës është angazhuar që "Pallati i Rinisë" ti kthehet qytetarëve në shërbim. Gjithashtu edhe në programin qeverisës të prezantuar nga LVV-ja në zgjedhjet e kaluara, është marrë si zotim që Komuna e Prishtinës do të përgatit një plan aksional për rimëkëmbjen dhe përfundimin e "Pallatit të Rinisë", renovimin e sallës së djegur, ndërtimin e pishinës olimpike, dhe lidhjen e pllatosë së pallatit me pllatonë e Hotel Grandit, prandaj në parim e mbështesim çdo punë dhe i japim përkrahjen tonë që kjo të ndodhë sa më parë. Tani kjo qasje është me të vërtetë e pandershme, jo korrekte, fyese dhe e papranueshme për qytetarët e komunës, se në pyetje janë afër 4 milion euro të qytetarëve tanë. Çfarë garancie kanë qytetarët e Prishtinës se këto para nuk do të keqpërdoren, ashtu siç janë keqpërdorur edhe parat për qumështin e nxënësve në këtë vit, apo të projekteve të tjera me të cilat është dashur të merret prokuroria dhe organet hetuese. Prandaj urgjentisht kërkojmë nga ekzekutivi që sa më parë të paraqes para Kuvendit planin aksional, sepse në fund të fundit është premtim i vetë kryetarit,

Sa i përket rastit të "IMN Kosova", ne edhe më herët i kemi përkrahur kërkesat e tyre, prandaj në parim do ta mbështesim këtë bartje të mjeteve. Por fatkeqësisht edhe në këtë rast nga komuna nuk kemi ndonjë analizë të paraqitur për këstin, për 20% për punëtorë, a janë këto mjete të mjaftueshme? Çfarë do të bëhet me pjesën tjetër.

I bëjmë thirrje kryetarit dhe ekzekutivit në përgjithësi që sa më parë edhe në këtë rast të përgatisin një raport të detajuar për pagesën e 20% për punëtorë, ta sjellin në Kuvendin Komunal, dhe të diskutojmë për planet në vazhdim, në lidhje me këtë çështje

**Migjen Shala** tha se ne si grup parlamentar çka është në të mirën e qytetarëve do ta përkrahim. Sa i përket "Pallatit të Rinisë" dhe Tjegullores ne e përkrahim transferimin e parasë për ato dy ndërmarrje. Sa u përket pagave dhe obligimeve, pasi që është një verdikt zyrtar i gjykatës, kështu që ne kemi mbulesë me e bërë këtë edhe për neve është e pranueshme.

**Arbenita Murseli** tha se e mirëpres vendimin që të bëhet ndarja e mjeteve financiare për ndërmarrjen e cila tash së fundi doli nën kompetencat e komunës. Po ashtu e rrugës është që të bëhet edhe pagesa e 20% për punëtorët e ndërmarrjes "IMN Kosova", se kjo është e drejta e tyre më themelore, por në anën tjetër kemi parasysh se po tërhiqen afro 6.2 milion euro, prej dy projekteve të tjera të rëndësishme, si ndërtimi i Fabrikës së ujit në Shkabaj dhe projekti për ndërtimin e Galerisë së arteve dhe shumë projekte të tjera vitale për Komunën. Nuk është në rregull të tërhiqen parat për projekte të tilla vitale e të mbesin të pa realizuara, nëse po, atëherë duhet të hidhen në rishikim të buxhetit në njërin nga seancat e ardhshme që do ti kemi e të ndahet edhe vija buxhetore për to. Përndryshe në parim jemi pro që të bëhet ndarja e mjeteve financiare për dy ndërmarrjet, duke e ditur edhe të kaluarën e tyre jo të lehtë.

**Fiknete Bejta** tha se kjo pikë e rendit të ditës është dashtë të ndahet në dy pika, sepse kemi një dallim në përmbajtje. Tek rasti "IMN Kosova" në emër të grupit të asamblistëve të AAK-së mendoj që jemi vonuar në kompensimin e këtyre qytetarëve, sepse kanë pritur shumë gjatë për të realizuar një të drejtë të tyre legjitime. Ndërsa tek puna e "Pallatit të Rinisë", ne si grup jemi të vetëdijshëm që këto 18 vite ky "Pallat i Rinisë" ka qenë një çerdhe e njëfarë lloj mafie të komunës, ku kanë shfrytëzuar rastin të keqpërdorin shumë subjekte politike, grupe të ndryshme të interesit dhe në fakt e kanë shkatërruar një qendër tregtare dhe shërbyese për qytetarët.

Por nëse nuk marrim masa dhe nuk ndërtojmë një plan strategjik se si ti tejkalojmë këto probleme të "Pallatit të Rinisë", atëherë ne vetëm kemi me u detyruar që çdo 6 muaj me kompensuar ose me subvencionuar prej buxhetit komunal. Nuk është e drejtë por mendoj që është e arsyeshme, ti merren mjetet për investime kapitale qytetarëve të lagjeve të ndryshme, siç është rasti i rrugës Mati 1, mirëpo edhe pse është i pazakonshëm ky rast, ne si grup parlamentar mendojmë që duhet ta përkrahim e ta votojmë edhe për rastin e "IMN Kosovës", edhe për "Pallatin e Rinisë".

**Shefki Gashi** fillimisht bëri vërejtje rreth materialit i cili tha se ky propozimvendim është dashtë të jetë më i kompletuar, i mungon arsyetimi.

Nuk e konsideroj të arsyeshme që të merren mjetet e qytetarëve, dhe të bëhet kjo pagesë për mallin e djegur aty në objektin e Pallatit të Rinisë, dhe Komuna e Prishtinës nuk ka obligimi ndaj kurrkuajt, kurrfarë obligimi nuk kemi hiq. Ne nuk kemi qenë garant kur e kanë lënë mallin, nuk ka pas garancion as atëherë, nuk ka pas me shkrim kurrgjë, ato janë manipulime të cilat i kanë bërë gjykatat e Kosovës, që për fat të keq po vazhdojnë me i bërë ato manipulime, pra dhe ne sot këtë borxh po e paguajmë me parat e taksapaguesve. Kjo z. Kryetar, mendoj se është një menaxhim shumë i keq, dhe me këtë shumë të mjeteve që kam llogaritur diku afër 6 milion euro kishim mundur me i marrë 60 kabinete për shkolla.

**Agim Gashi** tha se ne KPF e dhamë vërejtjen se vendimi nuk është i kompletuar, proceduralisht ky nuk duket si vendim, dhe ka pas kohë që ti bashkëngjitet arsyetimi i plotë dhe pastaj të votohet një dokument që teknikisht është në rregull dhe pasqyron një kuptim të cilin na ia japim me rastin e votimit. Sot praktikisht kryetari e ka marrë një obligim që ta bartë në Kuvend e të vendos për kompensimin e atyre obligimeve që dikush i ka shkaktuar, dhe kurrë nuk ka dhënë llogari pse i ka shkaktuar, me ndodhë gjithë ajo avari në "Pallat të Rinisë" dhe të kalojnë 18 vjet dhe kurrkush mos të përgjigjet.

Po ashtu është dashtë që të jepen disa sqarime paraprake dhe të njoftohen asamblistët se komuna ka marrë këto obligime, dhe ne duhet t'ia gjejmë zgjidhjen kësaj pune.

Asnjëherë kush asnjë fjalë nuk e ka thënë, dhe kjo ka ardhur si bombë përnjëherë mbledhje e jashtëzakonshme për një ditë, dy ditë, ku ti marrim na informacionet plotësuese për me e bindur veten që kjo është e drejtë e plotë dhe ka një rregullsi të plotë në këtë procedurë, për të cilën ne sot do të votojmë. Unë këtë e quaj papërgjegjësi, ose në njëfarë mënyre përbuzje e institucionit, nuk duhet me e përbuzur Kuvendin, nuk duhet me e përbuzur rolin që e ka komuna, kompetencat që i ka karshi kthimit të pronës edhe gjërave të tjera. Është dashtë me kohë të zhvillohen të zhvillohen

procedurat normale, me kohë të njoftohemi, të përgatitemi, ta dimë që po e marrim një vendim fisnik, edhe po i kthejmë pronat të cilat në mënyrë të padrejtë iu kanë marrë Komunës së Prishtinës.

**Eman Rrahmani** tha se në mbledhjen e KPF-së nënkryetari Selim Pacolli tha që do t'ua sjellim këtu marrëveshjen që është bërë me AKP-në për 20%, për pagesën e borxhit për punëtorët e ish Tjegullore, mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi.

Mendoj që kjo që është duke ndodhur këtu, përveç që kolegët reagues për fyerjet që po bëhen, është fyerje edhe më e madhe kjo që edhe me letër këtu që na bëhet, ku një buxhet do të thotë prej 6 milion euro të tjetërsohet në destinim, dhe vjen vetëm me një fletë. Pra, 6 milion euro hiqen prej investimeve kapitale, dhe nuk jepet asnjë arsytim i mëtutjeshëm, mendoj se këto 6 milion euro të cilat janë larguar prej investimeve kapitale, këtë do ta pësojnë qytetarët e Prishtinës me projekte të cilat edhe janë të paraqitura këtu.

Këtë dështim të shpenzimit ose të investimeve kapitale, ne si LVV e kemi adresuar qysh prej fillimit, mirëpo jemi injoruar nga ekzekutivi dhe janë përqeshur me kritikën tona që i kemi bërë.

Sa i përket IMN Kosova ne nuk kemi asnjë dokument se çfarë marrëveshje është bërë me AKP-në dhe pasuria e kësaj ndërmarrjeje nuk është ende në pronësi të Komunës së Prishtinës. Kërkojmë nga Zyra ligjore me interpretuar këtë punë se a mundemi me i ndarë mjete dikujt që realisht nuk e ka kthyer pronën në emër të komunës, përderisa nuk kemi asnjë marrëveshje.

**Egzon Azemi** tha se po gëzohem për punëtorët e IMN-së që më në fund do ta marrin atë që ju takon, pra, e marrin 20%, edhe besoj që ky grup i punëtorëve i ka dhënë shembull një qyteti të tërë e madje edhe një vendi, sepse u dëshmuar edhe njëherë që protesta dhe dalja në rrugë është e vetmja rrugë. Kështu që unë i ftoj të gjithë qytetarët e Prishtinës, ti bashkojnë hallet dhe brengat që i kanë dhe ti zgjedhin këto metoda, sepse këto janë metodat e vetme që sjellin rezultate, në një qeverisje të tillë pa asnjë rezultat. Rezultati i tyre është vetëm tradhtia që po ia bëjnë vendit si në nivelet lokale, e madje tash edhe në nivelin qendror.

Një person i cili nuk ka arritur ta menaxhoi që një vit komunën, një person i cili dështon që edhe zbulimin e qytetit ta bëjë në kohën e duhur, që është ndër gjërat më të lehta që ishte dashur me e bërë, një person i tillë i cili asnjë përgjegjësi nuk arrin ta marrë, po veç jep arsytime, po donë që të luaj tash edhe me fatin e Kosovës, paramendoni në dorën e kujt jemi. Na ndihemi keq dhe ju kemi kërkuar falje disa herë votueseve tanë, për shkak që kemi bërë thirrje me votuar një person të tillë, prandaj edhe njëherë po i ftoj të gjithë qytetarët pa dallim brengave dhe halleve që i kanë, duhet të organizohen e bashkërisht t'ia ndalim rrugën këtij që po ua vjedhë çdo send, çdo mënyrë e çdo pushtet.

**Sami Boroci** tha se është një lajm i mirë që Pallati i Rinisë" ju ka kthyer komunës, është në proces të konsolidimit, pra, si ndërmarrje komunale, mirëpo sa i përket borxhit i cili po figuron, është procesi gjyqësor që ka vendos dhe na sot duhet veç me e votuar. Sa i përket "IMN Kosovës" po besoj që veç krejt pajtohemi që duhet patjetër me e votuar, edhe ata punëtorë me e marrë pjesën e vetë, i kemi parë edhe na në protesta, i ka takuar

nënkryetari, i ka takuar ekzekutivi i komunës, kështu që po besoj që më në fund po realizohet qëllimi i tyre.

**Rifat Deri** tha se ikona e Prishtinës, Pallati i Rinisë u kthye në menaxhim të Komunës, por tash sfidat tona kanë me qenë edhe më të mëdha se nuk është kryer asgjë puna vetëm se e kemi marr në menaxhim, tash është problemi i madh se si kemi me menaxhuar.

Edhe për Ndërmarrjen e materialit ndërtimor Kosova, edhe aty ju përgëzoj është një vend shumë i mirë, shumë i vlefshëm.

Siç e dimë deri sot Pallati i Rinisë është menaxhuar nga AKP-ja, Komuna e Prishtinës nuk ka pasur qasje aty edhe në ndërmarrjen e IMN-s Kosova. Kështu që krejt këto mjete që janë paraqitur këtu në këtë tabelë unë i përkrahi.

**Sami Salihu**, propozoi që kjo pikë e rendit të ditës për votim të ndahet në dy votime.

**Vlora Dumoshi** tha se ne sot të gjithë kemi ardhur me një mbledhje urgjente për një hall, për një punë për Pallatin e Rinisë, të cilin me shumë vite e kemi pritur me qenë pronë e Prishtinës, edhe pse ne sot i shohim me shqetësim këto projektet të cilat janë paraparë me u marr e mu paguar një borxh i cili është i domosdoshëm.

Por krejt fakti i këtij diskutimi, i të gjithë njerëzve mos të them që secili projekt i cili merret nga buxheti i Komunës është i nevojshëm për qytetarët. Nuk po dua me kritikuar por çka po më lenë një përshtypje shumë të keqe edhe sidomos disa njerëz të cilët i njoh e janë të familjeve të mira, ndërhyjnë në diskutimet e anëtarëve të tjerë. Kërkoj që të kemi kujdes dhe qasjen ta kemi më pozitive kushdo që diskuton dhe ta respektojmë njëri tjetrin.

**Kryesuesi e hodhi në votim propozimvendimin**

**Kryesuesi konstatoi se me 37 vota për dhe 2 abstenime, u miratua vendimi për ndarjen e mjeteve Ndërmarrjes publike lokale "Pallati i Rinisë" SH.A në Prishtinë dhe ndërmarrjes "IMN Kosova".**

Mbledhja përfundoi në orën 15:25

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Agim Kuleta**



Faqe 6 nga 6